



## DEKLARATË POLITIKE E PKSH: QEVERIA VRET POPULLIN

PKSH, që nuk bën pjesë në shtabin e opozitës së bashkuar, duke shprehur zërin e së vërtetës, thellësisht të pavarur, në respekt të idealeve të popullit, deklaron solemnisht se demonstrata e 21 Janarit, me pjesëmarrjen e mijëra shqiptarëve pa parti, ishte në thelb demonstratë popullore, qëllimi i së cilës nuk qe rrëzimi i qeverisë me dhunë, por kërkesa absolutisht demokratike që qeveria e dhunës dhe korrupsionit të largohet nga pushteti. Kësaj demonstrate paqësore qeveria iu përgjigj me plumba sipas të gjitha kodeve dhe traditës fashiste.

PKSH, duke dënuar këtë akt fashist që mori jetët e qytetarëve Hekuran Deda, Ziver Veizi dhe Faik Myrtaj, shpreh dhimbjen e thellë për ta e për të gjithë ata që u plagosën e u torturuan në shesh të hapur apo në bodrumet e policisë. Ky gjak i pafajshëm u derdh jashtë gardhit të kryeministrit në sy të gjithë Botës, jo se populli i paarmatosur provokoi qeverinë, por se qeveria provokoi popullin me makina të zeza ujëhedhëse e gaz lotsjellës, deri edhe në përdorimin e armëve të zjarrit. Thashmë gjaku i pafajshëm rrjedh në duart e kryeministrit, merr udhë si në tragjeditë e Shekspirit për nga zyrat e parlamentit për të spërkatur fytyrën e kryeparlamentares, ngjitet në zyrat e presidencës e madje vete gjer në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Europës të mbajë një fjalim për demokracinë.

PKSH denoncon të gjithë ato zëra, të cilitdo qofshin, që spekullojnë me fraza steriotipe të propagandës alla Gebelsiane për gjoja shejtërinë e institucioneve. Populli më 21 Janar nuk kish ardhur për të sulmuar e marrë Bastijen ku mbretëron diktatori më i madh i Europës së ditëve tona, Sali Berisha, por të demonstrojë paqësisht përballë një institucioni që e ka njollosur me krime shejtërinë e misionit të vet. Sipas këtyre spekulloreve u dashka të bësojmë se institucioni ku mbretëron krimi është i shenjtë, ndërsa institucioni i demonstratës popullore e sovrani popull qenkan djalli. Është krejt e kundërta.

PKSH shpreh nderimin e saj për ata mijëra të rinj e të reja që më 21 Janar 2011 shpalosën në bulevardin "Dëshmorët e Kombit" mëngjesin e lëvizjes dhe rezistencës popullore kundër fashizmit në pushtet. Në të njëjtën kohë ajo shpreh indinjatën e saj të thellë që këta djem heroikë e paqësorë i cilësoi kokëpalarë, gjuhëpalari dhe ndërgjegjepalari Ilir Meta dhe huliganë, mercenarë e bashibozukë diktatori Berisha. Por populli e di dhe e sheh se kokëpalarët, huliganët, mercenarët dhe bashibozukët, apo gangsterët e modelit Meta që fryhet si Duçja, gjejnë strehim tek dy partitë në pushtet, se atje janë foletë e mafies, punës e parasë së pandershme.

PKSH hedh poshtë me neveri akuzën e neveritëshme se më 21 Janar qenkësh organizuar një puç kundër qeverisë. Puçet organizohen nga forcat ushtarake në pushtet, apo elementë brenda qeverisë. Akoma më e shëmtuar shfaqet akuza e gjoja grushtit të shtetit, aq me tepër nga një parti që më 14 Shtator 1998 pushtoi me dhunë Televizionin dhe Radion shtetërore, rrëmbeu me dhunë tanket e Gardës e dogji Tiranën. E megjithatë gjak nuk u derdh, ndërsa sot ish partia e grushtit të shtetit në pushtet, derdh gjakun e opozitës popullore që s'ka parë as në ëndërr ndonjë grusht shteti.

PKSH nuk çuditet kur dëgjon nga goja e kryeministrit se mund të vritën para kryeministrit tre, tridhjetë, të gjithë, nga që vrasjet janë, njëra nga kënaqësitë e tij të mëdha, sepse edhe Neroni, pasi vrau për pushtet Nënë e dogji Romën, kënaqej nga gjaku e flakët dhe këndonte me pasion këngën e djegies së Trojës. Zotëri kryeministër, ju mund të vrisni me gjeneralët fashistë e bashibozukë tre, treqind,

tremijë, por një popull të tërë nuk e vrisni dot. Kanë rënë perandori më të mëdha, do të bjerë edhe perandoria jotë e krimeve.

PKSH nuk çuditet as nga qëndrimi as mish as peshk i ndërkombëtarëve në deklaratimet e tyre hermetike, të pasinqertë, hipokrite, duke mos treguar me gisht vrasësin, por duke ngarkuar me të njëjtën përgjegjësi edhe xhelatin, edhe viktimën e duke bërë thirrje për kompromis e dialog. Po dialogu u vra me plumba. Komunistët e kanë bërë të qartë se ndërkombëtarëve pak u intereson se kush bën padrejtësi, mjafton që borgjezia të jetë në pushtet, qoftë edhe fashiste, por që nuk çënon interesat e tyre.

PKSH nuk çuditet as kur qeveria e diktaturës më të egër në Europë arreston dhjetra të rinj demonstrues e i torturon në bodrumet e policisë si Hauzdingu Manush Alimanin dikur në Shkodër dhe i detyron nënat shqiptare të shpërthejnë në britma "Lironi fëmijët tanë" si Mine Peza në demonstratën antifashiste, as kur kryeministri vrasësit i deklaroi heronj dhe shkel në sy të gjithë Botës kushtetutën, të ashtuquajturin shtet ligjor të së drejtës dhe urdhëron policinë të mos zbatojë urdhërin e prokurorisë për arrestimin e oficerëve gardistë, duke shkelur njëherësh edhe mbi gjykatat që do të gjykonin drejtësinë ose jo të arrestit, sepse kështu e kanë diktatorët absolutistë, zbatojnë me fanatizëm moton e xhaxha Luigjit të 14-të: Shteti jam unë.

PKSH nuk çuditet as kur diktatori Berisha për të mbuluar krimin e tij të 21 Janarit, deklaroi të organizojë të shtunën e 28 Janarit antimeetingun e karshillëkut ogurzi të një pjese të popullit kundër tjetrës. Nëse do të ndodhte kështu, ambasadori amerikan Aleksandër Arvizu do të ketë rastin të shohë pikërisht teatrin e zi të një pjese të popullit kundër tjetrës, të cilin e pati dënuar si një mënyrë veprimi e vjetër e despotëve plot dyqind vjet më parë presidenti i madh amerikan Tomas Xheferson.

PKSH nuk çuditet as nga servilizmi i disa mediave të korruptuara dhe disa çeta intelektualësh që, sa herë proteston populli, dalin kundër tij dhe shpejtojnë t'i lajnë këmbët diktaturës e t'i krehin bishtin, siç bënin gazeta Tomorri e Radio Tirana në kohën e nazifashizmit, siç bënin disa intelektualë pa Atdhe, mercenarë të kuesturave e gestapove të pushtuesve.

PKSH, duke mbështetur demonstratën e 21 Janarit e çdo demonstratë tjetër si ajo, mbështet popullin që kërkon bukë e drejtësi, jo Partinë Socialiste dhe Edi Ramën, apo socialdemokracinë në përgjithësi. Populli dhe vetëm populli ka të drejtën legjitime të ngrihet në revoltë kundër një qeverie ilegjitime ardhur në pushtet me dhunën e votës së vjedhur, që ka degjeneruar në institucion tenderash për një grusht klientokratësh matrapazë të paskrupull, ndërkohë që qytetarët e papunë përjetojnë varfëri të thellë dhe polarizimi social i jetës rritet përtej fantazisë. Një qeveri që të vret, që mburret se të vret, madje që deklaroi se do të jetë e gatshme të vrasë prapë, mund të detyrohet të largohet nga fronti i krimit vetëm me demonstrata të pandërprera, që marrin e duhet të marrin në emër të lirisë e të jetës përmasat e një revolucioni të pamposhtur demokratik në fushat e betejave paqësore, njëherësh dhe çdo ditë në çdo fshat e qytet të Shqipërisë.

Poshtë fashizmi!

Rroftë Rezistenca Popullore!

KOMITETI QËNDROR I PARTISË KOMUNISTE TË SHQIPËRISË

ZERI I SË VËRTETËS Nr. 427